



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të OE "Truly Nolen Sh.P.K." të datës 17.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 12.07.2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-4214-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e OE "Truly Nolen Sh.P.K." të datës 17.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 12.07.2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-4214-2-1-1.
- II. **MBETET NË FUQI** njoftimi mbi vendimin e datës 12.07.2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

OE "Truly Nolen Sh.P.K." (tutje "parashtruesi") me datë 17.07.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 12.07.2024 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-24-4214-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Lista e kontratave që kemi dorëzuar perbehet prej pese (5) projekteve ne institucione publike dhe vlera totale e projekteve është 1,200,606.16 Euro ndersa vlera e kerkuar nga AK per sherbime te ngjajshme është min 300,000.00 Euro, Ne si operator ekonomik kemi nenshkruar kontrate me AK KK "PRISHTINE" ME 18.05.2021 me kohezgjatje 36 muaj, por referenca është e leshuar me date: 16.11.2023 vlera e realizuar ne kete projekt ka arritur 784,700.00 deri me date 18.09.2023 . nga kjo mund te themi se vetem ky projekt i realizuar nga kompania jone arrin te permbush kushtin e Ak-se ne dosjen e tenderit te specifikuar min 300,000.00 Euro per referenca te ngjashme".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsye si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- Referencat te cilit i keni dorëzuar si dëshmi dokumentare ne baze te kërkesës për posedimin e kapacitetit teknik/profesional te përcaktuar ne pikën I te paragrafit 9.1&9.2 te FDT-se, nuk korrespondojnë me Listën e kontratave te realizuara ne tri vitet e fundit para publikimit te njoftimit për kontrate.

Pas administrimit me ofertën e parashtruesit është gjetur se të gjitha konstatimet dhe të gjeturat e komisionit vlerësues janë të sakta dhe të bazuara në tërësi. Konkretisht referencat e parashtruesit të dorëzuara si dëshmi dokumentare nuk korespondojnë me listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit para njoftimit për kontratë. Nëse analizohen pretendimet ankimore, as parashtruesi nuk e konteston këtë fakt pasi që i njëjti flet për listën e kontratave dhe nuk i konteston referencat. Prandaj pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 23.07.2024

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Page 2 nga 2

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net